

TAMPEP



**DASHURIA DHE  
KUJDESI PER VEHTEN**

## PERSE DUHEN KURUAR INFEKSIONET VAGINALE ?

PSE DUHET TE KUJDESOHANI PER SHENDETIN TUAJ ? SEPSE ASKUSH TJETER NUK E BEN PERVEÇ JUSH !

NE QOFTE SE INFEKSIONET VAGINALE NUK I SHEROJME, SIMPTOMAT MUND TE MOS I NDJEJME (KUPTOJME), POR SHPESH GJENDJA KEQESOHET, PROCESI I INFEKTIMIT KALON NGA VAGINA NE TUBAT DHE DERI NE VEZET, KESHTU MUND TE NGELESH STERILE (D.M.TH. TE MOS LINDESH FEMIJE). VECANERISHT I REZIKSHM ESHTË MOSKURIMI I INFEKSIONIT KUR JE SHTATZANE, SEPSE GJAT LINDJES JU MUND TI NGJISNI SEMUNDJEN FEMIJES TUAJ. DISA PREJ INFEKSIONEVE MUND TE KERCENOJNE SERIOZISHT SHENDETIN TUAJ. SKEMAT, QE NE PO JU PARAQESIM ME POSHTE JANE VETEM PER INFEKSIONET VAGINALE; SE CFARE DUHET TE BENI KUJT DHE KU DUHET TE DREJTOHANI NE RAST SEMUNDJEJE.

- KENI KUJDES PER SHENDETIN TUAJ, ASKUSH S'E BEN KETE PER JU !
- MOS KRYENI MARREDHENIE SEKSUALE VAGINALE E ANALE PA PREZERVATIVE. MOS PUNONI KUR KENI MESTURACIONET (PERIODAT).
- KONTROLLOHUNI RREGULLISHT TEK MJEKU.
- PREZERVATIVI ESHTË MBROJTJA NGA TE GJITHA KETO SEMUNDJE DHE NGA NJE SHTATZAN E PA DESHIRUAR.



### KUJDES !!!!

NE QOFTE SE NUK PERDOR PREZERVATIVEN KUR PUNON, MUND TE INFEKTOHESH ME KETO SEMUNDJE, QE SIPAS RADHES DHE SIMPTOMAVE NE TABELLE QUHEN:

- SIDA - HIV
- KLAMIDIA
- SIFILIZI
- HERPESI (INFEKSIONE VIRUSALE)
- SEMUNDJA E MELCISE, e tjera ...

PRANDAJ JU PATJETER DUHET TE BENI RREGULLISHT KONTROLLE TEK MJEKU. VECANERISHT KETO SEMUNDJE JANE TE RREZIKSHME GJAT SHTATZANISE, SEPSE MUND TJA NGJISNI SEMUNDJEN FEMIJES TUAJ.

# ANALIZA E (HIV) = SIDA

## ÇFARE ESHTË ANALIZA ?

Eshte nje analizë e thjeshtë e gjakut

Në Itali kjo analizë është private dhe anonime . Në qoftë se rezultati del pozitiv , je e lirë të pranosh (ose jo) kurat e mjekut . Në disa qendra (shiko listën e ambulancave) nuk e jep emrin tënd po qe se nuk dëshiron .Nuk të detyron askush të bësh analizën!

## KU TA BEJ ANALIZEN ?

Lexo listën e adresave të ambulancave.

## PERSE DUHET TA BEJ ANALIZEN ?

## CILAT JANE SJELLJET E RREZIKSHME ?

Janë mardhëniet seksuale pa prezervativ, dhe cdo shkëmbim gjaku me të tjerët.

1. Për të ditur në se jam negative ose pozitive .(P.SH. Mund t'ja ngjis fëmijes tim gjatë barrës).
2. Për njerzit që jetojnë pranë meje.
3. Sepse po të jem pozitive mund të bëj kura dhe të mos rëndo gjëndjen time .
4. Sepse po të jem negative mund të evitoj të bëj mardhënie me rrezik.

## KUR DUHET TA BEJ ANALIZEN ?

Që nga 1 deri 8 muaj pas mardhënieve me rrezik (pa prezervativ ose shkëmbim gjaku).Gjatë orarit hapur të ambulancës, dhe s'ka nevojë të jesh pa ngrënë.

**JU LUTEMI KENI KUJDES MBRONI VEHTEN, ESHTË PER SHENDETIN TUAJ!**

**ME DUKET SE JAM SHTATZENE.**

Sko tek farmacisti dhe blej një analizë (për shtatzaninë). Analizën mund ta bësh duke filluar që nga dita që prisje periodat. Që të jesh e sigurtë përsërit analizën pas 10 ditësh.

Analiza doli negative.  
Nuk jam me barrë.  
(shtatzënë)

E dua fëmijën: je rezidente (banuse),shko tek doktori familjar ose tek konsultoria e zonës. Në konsultore shërbimi është gratis (pa pagesë) dhe anonim (pa dokumenta). Po nuk je banuese do të paguash doktorin.

Në qoftë se analiza del pozitive .  
Jam me barrë.

**PO QE SE KAM DESHTUAR, NGA SE DUHET TE SHQETESOHEM.**

**PER TU SHQETESUAR**

1. Po qe se ke shumë humbje gjaku (sikur të jesh prerë nga dicka) e që vazhdon më shumë se 7 ditë.
2. Nga një temperaturë e lartë (më e lartë se 38,5° C e 39° C dhe dhimbje të forta).
3. Në qoftë se i ke këto simptoma, shko tek doktori ose në spital.

**TE MOS SHQETESOHEM**

1. Në qoftë se kam pak humbje gjaku. Mund të ndodhi edhe për 7 ditë.
2. E ndien veten të lodhur ? Bëj pushim !
3. Keni kujdes higjienën dhe pastrimin tuaj personal. Përdorni prezervativën po qe se bëni marrdhënie seksuale.
4. Mund të ngelni shtatzënë ( me barrë) mbas një aborti (dështimi). Keni kujdes, përdorni prezervativën ose ilaçe për të mos ngelur me barrë.

Nuk e dua fëmijën: në qoftë se jam rezidente (banuese) mund të shkoj në konsultore ose tek doktori për të kërkuar abortin (dështimin). Në Itali dështimi është i ligjshëm: vetëm në qoftë se bëhet brenda 12 javëve të para. Dështimi bëhet vetëm në spital.

Ato që nuk janë rezidente (banues me dokumenta) duhet të prenotojnë vizitën në spital për të dështuar. Për këtë rast dështimi paguhet.

**KENI DHEMBJE NE FUND TE BARKUT KUR JENI ME PERIODAT ?**

Keni temperaturë (mbi 38° C)  
Keni dhëmbje të forta ?

Jeni e sigurtë që nuk je shtatzënë ? Në qoftë se ke dyshim, blej një test (analizë) te farmacisti. (S'ke nevojë për recetë nga mjeku).

Në qoftë se pak kohë më parë keni dështuar, ose keni lindur fëmijë të vdekur apo një temperaturë të lartë (mbi 38° C) dhe dhëmbje të forta, mos humb kohë. Shko në spital.

Po qe se keni dhëmbje pa temperaturë, s' ke më rrjedhje giaku, s' ke më të therura të barkut, prisni 2 ose 3 ditë dhe vini re përsëri simptomat (shenjat)

Shko shpejt tek mjeku. Mund të kesh një infektion në mitër ose në vezët. Në mënyrë të veçantë duhet të keni kujdes, kur keni rrjedhje giaku në ditët që nuk jeni me periodat.

**CFARE MUND TE KEM NE QOFTE SE ME DJEG VAGINA, APO NE SE KAM DHEMBJE KUR URINOJ (BEJ SHURREN) ?**

Mund të keni një infektion të vaginës. Lexo me kujdes tabelën e sëmundjeve të zakonshme vaginale.

**MUND TI KESH TE DYA**  
Në qoftë se nuk zhduket në pak ditë, të djegurit dhe të kruajturit është e domosdoshme të shkosh tek mjeku. Në qoftë se nuk kurohesh, sëmundja keqësohet e mund të arrish deri aty sa të urinosh mbi vehte pa e kuptuar.

Mund të keni një infektion në sistemin e qarkullimit të urinës.

## TABELA E SËMUNDJEVE TE ZAKONSHME VAGINALE

EMRI	Candidiasi (të bardhat) (Myku)	Tricomoniasi (Trigomoni)	Infeksionet bakteriale dhe infeksione të tjera	Gonorea (Gonoreja)
NGJYRA	E bardhë, mund të jetë me damarë gri ose jeshil	E verdhë	E errët	E errët
ERA	Thartirë si majá birre	E fortë, si erë peshku era bëhet gjithnjë e më e fortë	E fortë e qelbur	E qelbur
PËRBËRJA, (SI FORTËSI PO TA PREKËSH)	Si kos	E lëngët, me rrjedhje të herë pas hershme	E lëngëshme	E lëngëshme
SASIA	Mund të jetë e bollshme	Zakonisht shumë	E ndryshueshme	Mund të jetë shumë e shpeshtë
TË KRUHET ?	Po, por disa gra kanë të krojtura në fillim, e disa më vonë	Po, mund të jetë me kruarje	Mund të jetë me kruarje	Mund të jetë me kruarje
KENI KUJDES	Mund të shpërndalet në pjesë të tjera të trupit, (gojë ,bythë e vaginë). Për këtë n.q. se do të kesh të tre marrëdhëniet me të njëjtin person, ndërro tre herë prezervativën!	Mund të ngatërrohet me gonorean, në qoftë se rrjedhjet janë më shumë jeshile se të verdha	Ndërro prezervativën pasi ke bërë marrëdhënie në bythë; Ki kudes, pasi del jashtë pastrohu mirë, që të mos infektosh vetvehten	Mund të shkaktojë dhëmbje anormale gjatë periodave dhe mund të infektojë pjesë të tjera të trupit
KURIMI	Shko tek doktori për tu kruar	Shko tek doktori për tu kruar	Shko tek doktori për vizitë, dhe po qe e nevojshme edhe për tu kruar	Shko tek doktori për vizitë, dhe po qe e nevojshme edhe për tu kruar